



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 1291 Prot.

Tiranë, më 09.11. 2018

*Shërkend to securove
Komisionit to Ekonomisë dhe
Financave.
Shërkend to mandatat
Për kryerje sivej Rregullesve*

Lënda: Dërgohet për miratim projekt-struktura organizative e Institutit të Statistikave

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

Të nderuar,

Në zbatim të Ligjit të ri nr.17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", neni 40, pika 5, ju dërgojmë për miratim Projekt-Strukturën e Institutit të Statistikave.

Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni:

1. Strukturën organizative të INSTAT
2. Organigramën dhe kategorizimin e pagave
3. Relacionin shpjegues të strukturës
4. Shkresën nr. nr.1291/4, datë 17.09.2018 të Departamentit të Administratës Publike
5. Shkresën nr. 1291/5 datë 24.10.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

DELINA IBRAHIMAJ



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazen Huta, Nd.35, H.1, Njesia Administrative Nr.2.1017, Tiranë

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al

RELACION
PËR PROPOZIMIN E MIRATIMIT TË PROJEKT-STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË
INSTAT 2018

INSTAT ka kryer rishikimin e strukturës organizative për të garantuar ecurinë e suksesshme të Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ) 2017-2021, në zbatim të rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë. Në ndërtimin e kësaj strukture janë reflektuar rekomandimet e dhëna në raportet e progresit për Kapitullin 18, “Statistikat”, si edhe ato të sugjeruara nga ekspertët e Eurostat (Light Peer Review, shtator 2018) dhe FMN, gjatë misionëve të tyre vlerësuese mbi sistemin statistikor në Shqipëri.

Kështu, propozohet të krijohen tre drejtori të përgjithshme të cilat, bazuar në fushat e përgjegjësisë së secilës prej tyre dhe duke mbajtur parasysh interesat më të mira të vendit për statistika zyrtare, do të asistojnë Drejtorin e Përgjithshëm në menaxhimin e institucionit. Gjithashtu, ato do të përcjellin synimet dhe vizionin e menaxhimit të tre drejtimeve të institucionit në agjencitë e tjera statistikore. Tre drejtoritë e përgjithshme do të mbulojnë: i) Prodhimin Statistikor; ii) Teknologjinë e Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënave; iii) Shërbimet Mbështetëse dhe Komunikimin. Domosdoshmëria e krijimit të drejtorive të përgjithshme lidhet edhe me rritjen e performancës së institucionit në drejtim, menaxhim, monitorim dhe ndjekje të çdo aspekti në realizimin e statistikave zyrtare: Prodhim, infrastrukturë dhe komunikim.

1. Drejtoritë e Përgjithshme që do të krijohen sipas fushës së përgjegjësisë janë:

i. Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor, e cila do të shërbejë:

- Për të asistuar Drejtorin e Përgjithshëm në menaxhimin e prodhimit statistikor;
- Për të menaxhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qendëruar prodhimin statistikor;
- Për të mbështetur drejtoritë prodhuese në rritjen e shkallës së efijencës;

- Menaxhim me eficiencë, drejtim, monitorim dhe ndjekje të qendëruar të aktiviteteve statistikore për të rritur performancën e institucionit në prodhimin statistikor;
- Për të njehsuar fazat dhe nënfazat e njëjta statistikore si në cens, vërtetim statistikor, burim administrativ dhe për të menaxhuar uljen e ngarkesës së prodhuesve të statistikave në nivel Sistemi Statistikor Kombëtar;
- Për të siguruar një cilësi të lartë të uniformëzuar të proceseve dhe produkteve statistikore sipas standardeve të menaxhimit të cilësisë, me anë të mjeteve monitoruese si vetëvlerësim dhe audit statistikor në nivel sistemi prodhues statistikor;

ii. Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënave, e cila do të shërbejë:

- Për të asistuar Drejtorin e Përgjithshëm në menaxhimin e infrastrukturës dhe teknologjinë e informacionit, metodologjinë e përdorur, bazat e të dhënave dhe cilësinë;
- Për të asistuar drejtoritë përbërëse në çështjet e mbledhjes së të dhënave, menaxhimin e tyre dhe metodologjinë e prodhimit statistikor;
- Menaxhimi i drejtpërdrejtë dhe i qendëruar i infrastrukturës së teknologjisë së IT dhe komunikimit me zyrat rajonale;
- Përmirësimin e procesit të planifikimit, realizimit, monitorimit dhe publikimit të informacionit statistikor gjeografik, në mbështetje të planit të statistikave zyrtare;
- Rritjen e shkallës së eficiencës në termat e infrastrukturës së proceseve dhe teknologjisë së informacionit.

iii. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit, e cila do të shërbejë:

- Për të asistuar Drejtorin e Përgjithshëm në menaxhimin e shërbimeve mbështetëse me efektivitet dhe eficiencë;

- Për të menaxhuar dhe koordinuar në mënyrë të qëndrueshme dhe funksionale planifikimin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër, dhe çështjet ligjore;
- Për një funksionim efektiv të rrjetit të komunikimit midis institucioneve përgjegjëse të Sistemit Kombëtar Statistikor;
- Për të koordinuar dhe bashkërenduar në mënyrë eficiente projektet në mbështetje të prodhimit statistikor, infrastrukturës dhe komunikimit;
- Për të rritur efikasitetin e komunikimit të statistikave zyrtare dhe shpërndarjen e informacionit.

Drejtoritë brenda drejtorive të përgjithshme janë grupuar në një formë të tillë që të ruajnë vazhdueshmërinë e realizimit të aktiviteteve në proces dhe përgjegjësinë për përmbushjen e tyre sipas PSZ-së 2017-2021, si dhe strategjisë shumëvjeçare të institucionit.

2. Sekretari i Përgjithshëm

Në zbatim të Ligjit nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, krijohet pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm në Institutin e Statistikave. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil në institucion. Ka rol kryesor në formulimin e politikave, koordinon dhe garanton përfshirjen e kontributeve të dhëna nga njësitë administrative dhe/ose institucionet e tjera gjatë procesit të formulimit të politikave, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulon institucioni.

3. Ndërtimi i dy drejtorive të reja:

A. Drejtoria e Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore

Drejtoria e Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore, krijohet si rezultat i ndryshimeve të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”, për të qëndrueshme dhe mirëmenaxhuar detyrat dhe kompetencat që ka institucioni në lidhje me koordinimin e Sistemit Kombëtar Statistikor, planifikimin, ndjekjen, përafrimin e prodhimit statistikor me standardet e Eurostat dhe çështjet e tjera të aspektit ligjor, për nevojat e institucionit.

Drejtoria e Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore nuk sjell impakt financiar pasi krijohet duke suprimuar pozicionin e “Koordinatorit për Sistemin Kombëtar Statistikor” sipas strukturës së mëparshme. Ajo përmban dy sektorë të cilët operojnë aktualisht në drejtoritë e tjera.

Drejtoria, përveç detyrave të zakonshme për zbatimin e legjislacionit shqiptar, do të jetë përgjegjëse për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që lindin nga Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” në lidhje me:

- a) Përgatitjen e Programit të Statistikave Zyrtare;
- b) Përgatitjen e Planit Vjetor për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare;
- c) Monitorimin e ecures së tyre dhe raportimin;
- d) Organizimin e takimeve çdo 6 muaj me institucionet prodhuese për ecurinë e Programit të Statistikave Zyrtare;
- e) Koordinimin e punës për plotësimin e pyetësorëve nga organizatat ndërkombëtare;
- f) Hartimin e raporteve të Drejtorit të Përgjithshëm mbi ecurinë e Sistemit Kombëtar Statistikor për Kuvendin;
- g) Hartimin e Raporteve për Këshillin e Statistikave;
- h) Hartimin dhe ndjekjen e ecures së marrëveshjeve ndër-institucionale;
- i) Vlerësimin e kuadrit ligjor për aktivitetet statistikore në shkallë vendi;
- j) Harmonizimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire* për fushën statistikore, në shkallë vendi;
- k) Dhënien e mendimeve paraprake për aktet ligjore të propozuara nga institucionet e tjera;
- l) Procedurat e penalizimit të institucioneve që nuk përmbushin detyrimet e njoftimit, shkelin konfidencialitetin etj.;
- m) Përgatitjen e udhëzimeve/rregulloreve që miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm për Sistemin Kombëtar Statistikor.

Sektorët brenda kësaj drejtorie janë të ndërlidhura ndërmjet njëra-tjetrës për sa i takon përgatitjes së programeve zhvillimore për Sistemin Kombëtar Statistikor dhe vetë institucionin, si dhe raportimin e ecures së tyre. Gjithashtu, bashkëpunimi ndërmjet këtyre sektorëve do të sigurojë përputhshmërinë e *Acquis Communautaire* në të gjitha aspektet e fushave statistikore. Numri i direktivave, rregulloreve etj., mbi të cilat bazohet veprimtaria e INSTAT dhe e prodhuesve të tjerë statistikorë, është mjaft e madhe. Për këtë arsye, këta dy sektorë do të

merren jo vetëm me përgatitjen e akteve ligjore në Shqipëri për përputhshmërinë, por edhe me planifikimin e raportimin e kësaj përputhshmërie (sipas nenit 8, pika 2/b e Ligjit nr. 17/2018).

B. Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve

Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve krijohet si rezultat i ndryshimeve të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”, dhe si kërkesë e domosdoshmëri në kryerjen e funksioneve që ka ky institucion në raport me përdoruesit, brenda dhe jashtë vendit. Krijimi i Drejtorisë së Komunikimit dhe Publikimeve është gjithashtu sugjerim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit për ngritjen në hierarki të koordinatorëve të të drejtës së informimit, në përputhje me Ligin Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve ka për detyrë të përmirësojnë nivelin e komunikimit institucional, rritjen e marketingut të prodhimit statistikor, si dhe rritjen e marrëdhënieve me përdoruesit apo të tjerë të interesuar në përmbushje të misionit të institucionit. Bazuar në Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane, kjo drejtori përcakton standardin për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare në kuadër të plotësimit të nevojave të përdoruesve, si dhe integritetit në BE.

4. Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritetit Evropian, që do të jetë nën varësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, është i nevojshëm për shkak të rëndësisë që ka ky sektor si pjesë e institucioneve që merren me raportimin dhe monitorimin e veprimtarisë statistikore në interes të përafrimit dhe integritetit në BE, në drejtim të koordinimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (SDG) në Sistemin Kombëtar Statistikor dhe vendosjen e një ure lidhëse në protokollin e marrëdhënieve ndërmjet statistikave ndërkombëtare dhe kombëtare.

5. Rishikimin e emërimit të Drejtorisë së Statistikave Rajonale duke e ndryshuar atë në Drejtorinë e Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit.

6. **Rishikimin e emërtimi të Sektorit të Hartografisë** duke e ndryshuar atë në GIS, pra Sektori i Gjeoinformacionit.
7. **Shtimin e një sektori në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve; Sektorin e Prokurimeve**, që do të jetë përgjegjës për koordinimin, mbarëvajtjen, ndjekjen dhe realizimin e procedurave të prokurimit publik, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
8. **Sektori i Koordinimit të Projekteve** në Drejtorinë e Integritit Evropian, Koordinimit të Projekteve IPA dhe Publikimeve kalon në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve.
9. **Shtimin e një sektori në Drejtorinë e Statistikave Ekonomike; Sektorin e Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit**, i cili do të mbulojë disa aktivitete Multi-Domain si “Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit”, “Kërkimi Shkencor dhe Zhvillimi”, “Inovacioni”, “Transporti”. Shkëputja e këtyre aktiviteteve statistikore nga sektorët aktualë ku bëjnë pjesë ka si qëllim prodhimin e treguesve të rinj, si edhe vazhdueshmërinë/konsolidimin e aktiviteteve në proces që rrjedhin në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të PSZ-së 2017-2021.
10. **Shtimin e një sektori në Drejtorinë e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit; Sektorin e Mjedisit dhe Pyjeve**, që do të kontribuojë në prodhimin e të gjitha statistikave vjetore në nivel vendi dhe rajonale në lidhje me treguesit mjedisor.
11. Do të shkëputet nga Drejtoria e Statistikave Ekonomike dhe do të kalojë në Drejtorinë e Statistikave të Sektorit Real, **Sektori i Tregtisë së Jashtme** me 1 + 2 punonjës. Sektori do të prodhojë vetëm me treguesit e tregtisë së jashtme, ndërkohë që treguesit e turizmit dhe transportit, që janë pjesë e punës së këtij sektori, do të vazhdojnë të jenë pjesë përbërëse e DSE-së. Për këtë arsye, nga 4 punonjës (1+3) që ka aktualisht Sektori i Tregtisë së Jashtme, do të bëhet me 3 punonjës (1+2). Një pozicion pune do qëndrojë pranë DSE-së.

12. Do të shkëputet nga Drejtoria e Statistikave Sociale dhe do të kalojë në DSSR, **Spektori i Tregut të Punës** (me 1+ 3 punonjës). Spektori do të prodhojë vetëm me treguesit e forcave të punës, ndërsa treguesit e mbrojtjes sociale do të vazhdojnë të jenë pjesë përbërëse e DSS-së. Për këtë arsye, nga 5 punonjës (1+4) që ka aktualisht Spektori i Tregut të Punës, do të bëhet me 4 punonjës (1+3). Një pozicion pune do qëndrojë pranë DSS-së.
13. Drejtorisë së Statistikave të Spektorit Real do i largohet **Spektori i Integritit, Modelimit dhe Analizës së të Dhënave Mujore dhe Tremujore** (1+2 punonjës). Ky sektor do të kalojë pranë Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit (DTI), duke qenë se misioni i këtij sektori, deri më tani, ka qenë i lidhur me integrimin e të dhënave të ndryshme mujore dhe tremujore si skedarët e TVSH-së, listë-pagesave dhe bilanceve, për të ndërtuar databaza të ndryshme në funksion të kërkesave të drejtorive prodhuese të INSTAT. Ky funksion mbështes për drejtoritë e tjera të INSTAT do të kalojë tek DTI në strukturën e re.
14. **Spektorit të Çmimeve** të DSSR, përveç çmimeve të konsumit dhe matjes së fuqisë blerëse, këtij sektori do t'i shtohen edhe treguesit e çmimeve të prodhimit dhe ndërtimit, së bashku me 2 punonjës shtesë. Këta tregues kalojnë nga Drejtoria e Statistikave Ekonomike në Drejtorinë e Statistikave të Spektorit Real. Spektori i çmimeve do të ketë në përbërje 5 punonjës (1+4), nga 3 (1+2) që ka aktualisht në strukturë. Në këtë mënyrë, të gjitha çmimet do të prodhohen nga një drejtori.
15. Pranë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit riorganizohen Spektorët e Cilësisë Statistikore, Bazave të të Dhënave dhe Metadatave, si edhe Spektori i Integritit, Modelimit dhe Analizave të të Dhënave Mujore dhe Tremujore, i cili ka qenë pjesë e Drejtorisë së Statistikave të Spektorit Real. Këta tre sektorë riorganizohen në dy sektorë: **Spektori i Cilësisë dhe Metadatave**, si edhe **Spektori i Bazave të të Dhënave dhe Aksesit në Mikrodata**.

PËRBËRJA E ORGANIKËS

Propozohet që struktura organizative e institucionit të jetë e ndërtuar si më poshtë:

I. DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm janë përcaktuar në Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare.

II. SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil në institucion. Përveç detyrave të veçanta, të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi, ai ka rol kryesor në formulimin e politikave; koordinon dhe garanton përfshirjen e kontributeve të dhëna nga njësitë administrative dhe/ose institucionet e tjera gjatë procesit të formulimit të politikave, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulon institucioni; siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikat, duke ndjekur rregullisht procesin dhe duke marrë masa për zgjidhjen e problemeve; është përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të institucionit dhe përgjigjet përpara nëpunësit të parë autorizues në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; analizon raporte; menaxhon nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë të institucionit; organizon punën dhe përcakton detyrat sipas njësive kryesore administrative; identifikon mundësitë për reduktim të shpenzimeve, për përmirësim të politikave, programeve dhe performancës institucionale; garanton respektimin e afateve në nxjerrjen e akteve administrative dhe ruajtjen e sekretit shtetëror; përfaqëson institucionin, me autorizim të titullarit, brenda dhe jashtë vendit; kryen detyra të tjera të ngarkuara nga titullari i institucionit.

III. DREJTORIA E PUBLIKIMEVE DHE KOMUNIKIMIT (1+1+4+1)

Misioni i Drejtorisë së Publikimeve dhe Komunikimit është të botojë, shpërndajë, t'u shërbejë përdoruesve brenda dhe jashtë vendit dhe të marketojë produktin statistikor të INSTAT, duke pasur në qendër të vëmendjes plotësimin e kërkesave të përdoruesve. Gjithashtu, pjesë e misionit të kësaj drejtorie është të përgatisë publikimet në përputhje me standardet evropiane dhe t'i shpërndajë ato bazuar në Parimet e Statistikave Evropiane.

Detyrat kryesore të Drejtorisë së Publikimeve dhe Komunikimit janë:

- Organizon, drejton dhe kontrollon të gjithë aktivitetin e Publikimeve dhe Shpërndarjes së Informacionit
- Përgatit kalendarin e publikimeve për të gjithë vitin, në bashkëpunim me drejtoritë e statistikave prodhuese dhe agjencitë e tjera statistikore
- Është përgjegjëse për përditësimin e informacionit statistikor në faqen zyrtare të internetit të institucionit
- Monitoron, analizon dhe përgatit raporte periodike për faqen e internetit të institucionit
- Mirëmban databazën e përdoruesve si edhe listën e kufizuar falas të botimeve që janë për marketing, të cilat miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm
- Kontrollon zbatimin e listës së përdoruesve për shpërndarjen falas të botimeve të INSTAT, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm
- Përgjigjet për të gjithë procesin e botimit, shpërndarjes dhe marketingut të informacionit statistikor, që publikon dhe shpërndan INSTAT-i, si edhe për kërkesat specifike të përdoruesve vendas dhe të huaj
- Është përgjegjëse për përdorimin e të gjithë kanaleve të komunikimit për shpërndarjen e informacionit statistikor dhe promovimin e tij, përfshirë dhe mediet sociale.
- Përgatit dhe dizajnon, në bashkëpunim me sektorin e cilësisë statistikore, pyetësin IMAZH të INSTAT, Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.

Drejtoria e Publikimeve dhe Komunikimit është konceptuar si një drejtori me 2 sektorë, me 1 (një) përgjegjës dhe 4 specialistë, gjithashtu 1 (një) punonjës biblioteke. Funksionet e specialistëve janë të lidhura drejtpërdrejt me punët aktuale që sot zhvillohen nga Sektori i Publikimeve dhe Shpërndarjes së Informacionit, si dhe detyrat e reja që lindin në kuadër të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikatat zyrtare” ku përcaktohen disa funksione të reja.

Sektori i Publikimeve dhe Marketingut (1+2) do të shërbejë për editimin, standardizimin dhe publikimin në faqen e internetit të INSTAT të produkteve statistikore. Ky sektor do të mbulojë editimin e njoftimeve statistikore, botimeve të librave, publikimeve digjitale, dokumenteve elektronike sipas standardeve të vendosura nga institucioni, si dhe përditësimin e tyre në faqen e INSTAT sipas orarit dhe kalendarit të paracaktuar të publikimeve. Gjithashtu, sektori do të

monitorojë dhe gjenerojë raporte periodike për kohën dhe publikimin e statistikave zyrtare të agjencive statistikore, përfshirë INSTAT, sipas kalendarit të publikimeve. Marketingu dhe menaxhim produkti do të merret me organizmin e fushatave për promovimin e produktit statistikor, si dhe përgatitjen e produkteve dhe shërbimeve që INSTAT do të kryejë me pagesë, bazuar në Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”. Do të merret gjithashtu me evidentimin e panaiereve dhe konferencave për promovimin e produkteve statistikore specifike, si revista shkencore, apo publikimet e dedikuara për grup përdorues specifikë. Ky sektor sugjeron përdorues target për shitjen e produktit statistikor si dhe harton plane marketingu për produkte specifike me pagesë. Dizajnimi i botimeve, pyetësorëve dhe infografikëve të INSTAT, mbulon procesin e dizajnit dhe përgatitjes për shtyp apo publikim online të botimeve të INSTAT, sipas standardeve të përcaktuar nga strategjia e institucionit. Gjithashtu merret me përgatitjen e pyetësorëve në programet e dizajnit për anketat që zhvillon INSTAT. Është përgjegjës për prodhimin e broshurave, fletëpalosjeve, infografikëve si dhe çdo lloj materiali tjetër promovues dhe informues sipas kërkesave që ka institucioni.

Sektori Marrëdhënieve me Publikun (0+2) do të ketë dy specialistë:

Specialisti për Monitorimin dhe Raportimin mediatik do të mbulojë procesin e raportimit mediatik, gjenerimin e raporteve ditore, 6-mujore dhe vjetore. Analizimin e publikimeve dhe artikujve në medien vizive dhe atë të shkruar. Gjithashtu përgatitjen e raporteve mediatike ditore për Drejtorin e Përgjithshëm të INSTAT-it. Menaxhimin e adresës media@instat.gov.al dhe shpërndarjen e produkteve statistikore te ky grup përdorues. Është pikë kontakti për European Statistical System (ESS) për dërgimin e informacioneve dhe publikimeve më të fundit të INSTAT në këtë portal.

Specialisti për menaxhimin dhe përpunimin e kërkesave të përdoruesve do të mbulojë të gjitha kërkesat e përdoruesve për statistika që vijnë në adresën info@instat.gov.al si dhe kërkesave që i drejtohen institucionit me postë, apo direkt me formën e aplikimit për të dhëna në institucion. Do të mirëmbajë dhe përditësojë databazën e kërkesave të përdoruesve, si dhe përgatitjen e raporteve periodike për Programin e Transparencës, të bazuar në ligjin për të drejtën e informimit si dhe për përgatitjen e Anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve. Është pikë kontakti e User Support në faqen e

EUROSTAT, seksioni “SHQIP” ku adresohen kërkesat për informacion statistikor në gjuhën shqipe.

IV. SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE INTEGRIMIT EVROPIAN (1+2)

Spektori koordinon dhe ndjek ecurinë e indikatorëve të objektivave për zhvillim të qëndrueshëm. Mban në mënyrë të vazhdueshme kontaktet me Ministrinë e Integrimit, institucionet homologe, Eurostat, institucione të tjera dhe organizatat ndërkombëtare në kuadër të Integrimit Evropian. Spektori kujdeset për pritjet protokollare, organizimin e aktiviteteve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit si seminare, konferenca etj.

V. SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM (1+2)

Spektori i Auditit të Brendshëm, do të ketë të njëjtat detyra e përgjegjësi si dhe do qëndrojë e pandryshuar për sa i përket organizimit strukturor.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRODHIMIT STATISTIKOR

VI. DREJTORIA E LLOGARIVE KOMBËTARE (1+4+13)

Në kuadër të ristrukturimit të Institutit të Statistikave, duke marrë parasysh detyrat e detajuara për zhvillimin e statistikave të Llogarive Kombëtare dhe objektivat e parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021, propozohet që Drejtoria e Llogarive Kombëtare të mbetet e organizuar në 4 sektorë, duke mos përfshirë Sektorin e Llogarive Kombëtare Tremujore i cili është riformatuar në një drejtori të veçantë me të gjithë treguesit e sektorit real tremujor/mujor, me synimin e ndërtimit të një strukture organike të qëndrueshme dhe funksionale.

Drejtorja e Llogarive Kombëtare është përgjegjëse për përpilimin dhe koordinimin e gjithë sistemit të Llogarive Kombëtare. Kjo Drejtori funksionon e ndarë në 4 sektorë, sipas strukturës së mëposhtme:

Spektori i Llogarive Kombëtare Vjetore (1+4): Ka si objektiv kryesor vlerësimin e PBB-së me metodën e Prodhimit, me çmime korrente dhe me çmimet e vitit paraardhës. Ky sektor është

përgjegjës për llogaritjen e Outputit, Konsumit Ndërmjetës dhe Vlerës së Shtuar, sipas aktiviteteve ekonomik dhe vlerësimeve të ekonomisë së pavrojtuar.

Spektori i Llogarive të Sektorëve Institutionalë (1+3) që ka 3 objektiva:

- Vlerësimin e PBB-së me metodën e Shpenzimeve
- Përpilimi i Llogarive jofinanciare sipas sektorëve Institutionalë
- Vlerësimi i treguesit të të Ardhrave Kombëtare Bruto.

Spektori i Llogarive Kombëtare të Administratës Publike Qendrore dhe Rajonale (1+3) është përgjegjës për:

- Vlerësimin e treguesve të Administratës Publike në frekuencë tremujore dhe vjetore
- Vlerësimin e treguesve Rajonal të Vlerës së Shtuar dhe PBB-së sipas NUTS2/3

Spektori Sintezë i Llogarive Kombëtare (1+3) ka për detyrë përpilimin e tabelave Burim-Përdorime me çmime korrente dhe çmimet e vitit paraardhës, si edhe përpilimin e tabelave simetrike Input-Output.

VII. DREJTORIA E STATISTIKAVE TË SEKTORIT REAL (1+4+12)

Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real (DSSR), sipas strukturës aktuale të propozuar, pëson ndryshime dhe një rritje, duke kaluar nga drejtori me 3 sektorë (10 punonjës) në drejtori me 4 sektorë (17 punonjës).

Misioni i Drejtorisë së Statistikave të Sektorit Real do të vazhdojë të jetë përpilimi i statistikave makroekonomike në frekuencë të shpeshta kohore për vlerësimin e performancës së ekonomisë në Shqipëri. Përveç treguesve të çmimeve të konsumit dhe llogarive kombëtare tremujore, pjesë përbërëse e kësaj drejtorie do të jenë edhe treguesit e tjerë makroekonomike si treguesit e Tregtisë së Jashtme, Tregut të Punës, Çmimet e Prodhimit dhe treguesit e Kushtimit në Ndërtim.

Kalimi në DSSR i të gjithë treguesve makroekonomikë afatshkurtër, të cilët kanë jo vetëm lidhje dhe impakt ndaj njeri-tjetrit, por edhe një rëndësi të veçantë në vlerësimin e përgjithshëm të performancës makroekonomike të vendit, do të ndihmojë në menaxhimin më të mirë të tyre dhe rritjen e cilësisë së treguesve.

Sektori i Llogarive Kombëtare Tremujore (1+3), do të ketë të njëjtat detyra dhe përgjegjësi, por do të shtohet një person (1+3). Objektivi i këtij sektori është vlerësimi në nivel kombëtar i treguesit të Produktit të Brendshëm Bruto Tremujor me metodën e prodhimit dhe të shpenzimeve në përputhje me konceptet e ESA 2010 dhe SNA 2008.

Sektorit të Çmimeve (1+4), përveç detyrave aktuale, do i shtohen dhe çmimet e prodhimit dhe kushtimit në ndërtim. Gjithashtu, në strukturën e tij do jenë dhe dy punonjës shtesë, duke kaluar nga 1+2, në 1+4 punonjës. Objektivi i tij i ri do të jetë prodhimi në kohë dhe me cilësi të statistikave mbi Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), vërtetimet e ndryshme të Matjes së Barazisë së Fuqisë Blerëse, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (ICP, ICI, ICE) dhe Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (IKN).

Sektori i Statistikave të Tregut të Punës (1+3), do të ketë në përbërje 4 punonjës dhe objektivi i tij do të jetë prodhimi i statistikave të tregut të punës.

Sektori i Tregtisë së Jashtme (1+2), do të ketë në përbërje 3 punonjës dhe objektivi i sektorit do të jetë prodhimi i statistikave të import-eksporteve të të mirave në Shqipëri.

VIII. DREJTORIA E STATISTIKAVE EKONOMIKE (1+4+13)

Struktura e kësaj drejtorie është reduktuar nga 20 në 18 punonjës. Drejtorja pëson ndryshime si pasojë e shkëputjes së aktivitetit të Çmimeve të Prodhimit dhe Treguesve të Tregtisë së Jashtme, të cilët në vetvete janë tregues makroekonomikë me frekuencë mujore dhe tremujore.

Treguesit e Tregtisë së Jashtme, të cilët kalojnë tek Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real, duke qenë se janë tregues makroekonomikë me frekuencë mujore, i përshtaten në këtë mënyrë edhe strukturave organizative të vendeve të tjera të cilat grupojnë në një njësi të gjithë treguesit makroekonomikë me frekuencë të lartë.

Aktiviteti i Turizmit i kalon Sektorit të Statistikave Afatshkurtra nisur nga zhvillimet e turizmit në vend. Nevoja për informacion statistikor ka çuar në propozimin që këtij sektori t'i shtohen edhe detyra të tjera që kanë të bëjnë me prodhimin e statistikave të turizmit në ndërmarrje.

Aktiviteti i PRODCOM shkëputet nga Sektori i Statistikave Afatshkurtra dhe i bashkëngjitet Sektorit të Statistikave Strukturore i cili në vazhdimësi ka mbledhur treguesit e prodhimit në njësi të produkteve.

Struktura organizative e drejtorisë është rikonceptuar si më poshtë:

Sektori i Statistikave Strukturore (1+4). Statistikat Strukturore pranë ndërmarrjeve nxjerrin, interpretojnë dhe analizojnë statistika mbi aktivitetet që prodhojnë të mira materiale dhe shërbime. Ky sektor do të mbulojë aktivitetet mbi Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve. Gjithashtu, ky sektor do të mbulojë sigurimin dhe prodhimin e statistikave mbi energjinë elektrike, të cilat bazohen kryesisht në të dhëna administrative, si edhe statistikat mbi PRODCOM.

Sektori i Statistikave Afatshkurtra (1+5), i cili prodhon kryesisht tregues afatshkurtër mujorë dhe tremujorë pranë ndërmarrjeve ekonomike për aktivitetet industri, ndërtim, tregti dhe shërbime, duke përfshirë edhe treguesit e turizmit në ndërmarrje.

Sektori i Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve (1+2), merret me menaxhimin e burimeve administrative e statistikore për krijimin dhe përditësimin e Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve dhe Regjistrit të Njësive Lokale. Punonjësit e sektorit do të punojnë kryesisht me përditësimin e të dhënave të regjistrave statistikore, si dhe do të menaxhojnë ekstraktet e tyre për akses ndaj përdoruesve.

Sektori i Statistikave të R&D, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit (1+2), i cili do të mbulojë Statistika mbi TIK, Statistika mbi Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin, Statistika mbi Inovacionin dhe Statistikat mbi Transportin.

IX. DREJTORIA E STATISTIKAVE SOCIALE (1+4+13)

Drejtoria e Statistikave Sociale, sipas strukturës së propozuar, ka një zvogëlim të sektorëve nga 5 në 4. Si rrjedhim, numri i përgjegjësve të sektorëve kalon nga 5 në 4 dhe numri i specialistëve kalon nga 16 në 13. Përveç këtij ndryshimi, riorganizohet edhe ndarja e aktiviteteve brenda drejtorisë, duke pasur parasysh aktivitetet që do të kryhen gjatë kohës në vijim, deri në përfundim të programit zyrtar.

Sektori i Statistikave të Tregut të Punës kalon pranë Drejtorisë së Statistikave të Sektorit Real, duke përfshirë në këtë kalim aktivitetet që lidhen me treguesit e tregut të punës dhe të kostos së saj. Drejtoria mban të përfshirë një nga specialistët i cili, i ngarkuar me zhvillimin e statistikave të mbrojtjes sociale, ka për detyrë të zbatojë sistemin e integruar të mbrojtjes sociale (ESSPROS). Sipas PSZ-së aktuale, ky sistem është parashikuar të ketë një ndërtim gradual gjatë 5 viteve derisa në vitin e fundit të programit (2021) i gjithë sistemi të jetë i përfunduar.

Përveç këtij ndryshimi, riorganizohen aktivitetet dytësore të përfshira në sektorët e Statistikave të Popullsisë, Analizave Socio-Demografike (i cili merr emrin Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale) dhe Nivelit të Jetesës, duke rishpërndarë midis tyre statistikave të shëndetit, arsimit, projeksioneve dhe mbrojtjes sociale.

Sektori i Statistikave të Popullsisë (1+3), është sektor që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese dhe mbulon fushën statistikore të demografisë, statistikave vitale, migracionin, të huajt dhe azilantët. Dy aktivitetet e tjera të rëndësishme të këtij sektori, si mbulimi i statistikave të shëndetësisë dhe arsimit, i kalojnë sektorëve të tjerë ndërsa rritet fokusi në statistikave të migrimit dhe shtohen çështjet e diasporës. Për një riorganizim me qëllim rritjen e efikasitetit dhe shfrytëzimit të burimeve, aktiviteti i llogaritjes së projeksioneve dhe përditësimit të tyre kalon në këtë sektor. Së fundmi, ky sektor është dhe baza e përgatitjes së Censit të Popullsisë dhe Banesave dhe do të mbulojë projeksionet e popullsisë.

Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale (1+4), është sektor që funksionon sipas strukturës ekzistuese, duke pasur në fushën e mbulimit analiza socio-demografike, statistikave me bazë gjinore. Ky sektor mbulon gjithashtu fushën e drejtësisë, kulturës dhe sporteve. Sektori do të përfshijë në detyrat e tij edhe prodhimin e statistikave të arsimit (duke marrë për këtë qëllim edhe specialistin përkatës) dhe do të kryejë vërtetimet statistikore të nevojshme për të prodhuar treguesit e fushave të mbulimit. Ky sektor do të mbulojë edhe detyrat e statistikave të shëndetësisë.

Sektori i Statistikave të Nivelit të Jetesës (1+3), është sektor që funksionon sipas strukturës ekzistuese, duke mbuluar prodhimin e statistikave të të ardhurave dhe nivelit të jetesës nëpërmjet anketës SILC. Kjo anketë do të prodhojë në mënyrë të qëndrueshme tregues të krahasueshëm me vendet e BE dhe të përshtatshëm për hartimin dhe monitorimin e politikave efektive në funksion të

zhvillimit dhe përfshirjes sociale në vend, si dhe një sërë treguesish që pasqyrojnë një fushë të re të Eurostat mbi cilësinë e jetës.

Spektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve (1+3), është sektor ekzistues dhe ka mbuluar fillimisht kryerjen e Anketë së Buxhetit të Familjes e cila kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe shërben si bazë për përditësimin real të Indeksit të Çmimeve dhe Konsumit Final të Familjeve, si pjesë e Produktit të Brendshëm Bruto. Sektori mbulon aktualisht, sipas aktiviteteve të reja të Programit Statistikor Zyrtar, edhe dy anketa të tjera: Anketën e Turizmit “Pushime dhe Udhëtime” me periodicitet tremujor dhe Anketën e Përdorimit të Teknologjisë dhe Informacionit pranë Familjeve dhe Individëve. Gjithashtu, ky sektor duhet të kryejë një vrojtim kompleks siç është Anketa e Përdorimit të Kohës apo vrojtime të tjera me natyrë të ngjashme në vijim të zgjerimit të aktiviteteve statistikore dhe nevojave të të tretëve në kuadër të bashkëpunimit.

X. DREJTORIA E STATISTIKAVE TË BUJQËSISË DHE MJEDISIT (1+4+8)

Drejtoria e Bujqësisë dhe Mjedisit, sipas strukturës aktuale të propozuar, pëson rritje në numrin e punonjësve nga 10 në 13, si pasojë e rritjes së numrit të punonjësve në disa sektorë si dhe krijimit të sektorëve të rinj brenda drejtorive në funksion të vijueshmërisë së procesit të punës. Kjo drejtori siguron prodhimin e treguesve statistikorë për sektorin bujqësor si dhe atë të mjedisit, duke mbuluar jo vetëm strukturën e fermave dhe tipologjinë e tyre, ndotjen e ajrit dhe ujërave, por edhe llogaritë ekonomike të sektorit bujqësor dhe atij mjedisor.

Spektori i Statistikave të Tokës dhe Prodhimit Bimor (1+2). Sektori i statistikave të produkteve bimore dhe përdorimit të tokës ka si objektiv që, në mbështetje të kërkesave të Programit Kombëtar Statistikor, të organizojë punën për grumbullimin, kontrollin, përpunimin, prodhimin dhe analizën e treguesve të prodhimit bimor dhe përdorimit të tokës, si dhe statistikave agromonetare, me periodicitet tremujor dhe vjetor.

Spektori i Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit (1+2). Sektori i statistikave të blegtorisë dhe peshkimit mbulon prodhimin e të gjitha statistikave mujore, tremujore, vjetore në nivel vendi dhe rajonale në lidhje me blegtorinë dhe peshkimin. Ky sektor llogarit Prodhimin e Brendshëm Bruto

për sektorin e blegtorisë dhe peshkimit dhe koordinon punën me sektorin e çmimeve të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

Sektori i Statistikave të Mjedisit dhe Pyjeve (1+2). Ky sektor do të jetë i ri. Misioni i tij do të kontribuojë në prodhimin e të gjitha statistikave vjetore në nivel vendi dhe rajonal në lidhje me treguesit mjedisor. Këto tregues, deri më tani, janë mbuluar nga një specialist, por rritja e kërkesave si dhe e rëndësisë së sektorit mjedisor sjell nevojën për shtimin e treguesve statistikorë që lidhen me mjedisin, me fokusin në treguesit e ajrit dhe ndotjes së tij, ndotësve në sektorin bujqësor, trajtimin e ujërave sipërfaqësorë dhe të nëndheshëm, si edhe mbetjeve urbane, industriale, etj.

Sektori i Statistikave të Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis (1+2). Është sektor që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi. Sektori i Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis ka si objektiv kryesor të prodhojë në kohë dhe me cilësi treguesit statistikorë të tij, në përputhje me kërkesat e Programit Kombëtar Statistikor. Ky sektor përfshin Indekset e Çmimeve të Outputit dhe Indeksin e Çmimeve të Inputeve.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

XI. DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (1+5+22)

Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit, sipas strukturës së propozuar, pëson rritje në numrin e punonjësve nga 25 në 28, si pasojë e rritjes së numrit të punonjësve në disa sektorë dhe ndryshimit të varësisë brenda drejtorive në funksion të vijueshmërisë së procesit të punës. Kjo drejtori siguron mbështetjen me teknologjinë e duhur elektronike dhe kompjuterike për procesin e prodhimit statistikor, mbështetjen metodologjike, përmirësimin e metodave të administrimit të të dhënave, ruajtjen e konfidencialitetit statistikor si dhe informacion mbi cilësinë e statistikave zyrtare dhe metadat.

Sektori i Hedhjes së të Dhënave kalon pranë Drejtorisë së Statistikave Rajonale, e cila merret me procesin e mbledhjes së të dhënave nga vrojtimet si edhe me hedhjen e këtyre të dhënave në format

elektronik. Ndërkohë, pranë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit riorganizohen sektorët e Cilësisë Statistikore, Bazave të të Dhënave dhe Metadatave si edhe Sektori i Integritit, Modelimit dhe Analizave të të Dhënave Mujore dhe Tremujore, i cili ka qenë pjesë e Drejtorisë së Statistikave të Sektorit Real. Këta tre sektorë riorganizohen në dy sektorë: Sektori i Cilësisë dhe Metadatave dhe Sektori i Bazave të të Dhënave dhe Aksesit në Mikrodata.

Sektori i Zhvillimit të Programeve Kompjuterike (1+4) është sektor që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi. Objektivat e këtij sektori janë të krijojë, mirëmbajë programe kompjuterike, në përgjigje të nevojave të drejtorive të prodhimit të statistikave të INSTAT, në funksion të prodhimit të statistikave asnjënjëse, transparente dhe të përditësuara. Ky sektor mirëmban teknikisht faqen zyrtare të INSTAT.

Sektori i Administrimit të Rrjetit dhe Serverëve (1+2) është sektor që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtat detyra dhe përgjegjësi. Objektivi e këtij sektori është të krijojë dhe mirëmbajë një mjedis kompjuterik të përshtatshëm dhe të sigurt nga ndërhyrjet e brendshme dhe të jashtme. Ky sektor pëson rritje me një specialist si pasojë e ngarkesës së lartë dhe numrit të madh të përdoruesve të rrjetit të INSTAT.

Sektori i Metodologjisë (1+6) është sektor që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese. Objektivi i këtij sektori është të mbështesë nga ana metodologjike vërtetimet statistikore në përputhje me programin e statistikave zyrtare. Ky sektor pëson rritje me dy specialistë për shkak të volumit të lartë të punës, si pasojë e shtimit të aktiviteteve të prodhimit statistikor si edhe koordinimit të aktiviteteve ekzistuese, për të optimizuar proceset e prodhimit statistikor, duke marrë në konsideratë ngarkesën e të intervistuarve.

Sektori i Cilësisë dhe Metadatave (1+4) është sektor që krijohet si pasojë e riorganizimit të sektorit të Cilësisë Statistikore dhe sektorit të Bazave të të Dhënave dhe Metadatave. Objektivat e këtij sektori janë të sigurojë cilësinë statistikore për çdo aktivitet dhe fazë të proceseve statistikore, dhe të mirëmbajë sistemin e metadatave, në bashkëpunim me sektorët e prodhimit të statistikave. Ky riorganizim detyrash vjen në funksion të optimizimit të procesit të prodhimit statistikor, duke

marrë në konsideratë që të njëjtat standarde përdoren për dokumentimin e metadatave dhe raportet e cilësisë.

Spektori i Menaxhimit të Bazave të të Dhënave dhe Aksesit në Mikrodata (1+6) është sektori që krijohet si pasojë e riorganizimit të sektorit të Bazave të të Dhënave dhe Metadatave dhe sektorit të Integritetit, Modelimit dhe Analizave të të Dhënave Mijore dhe Tremijore, i cili ka qenë pjesë e Drejtorisë së Statistikave të Sektorit Real. Objektivat e këtij sektori janë të krijojë e mirëmbajë bazat e të dhënave, integrojë të dhënat në bashkëpunim me sektorët e prodhimit të statistikave dhe sigurojë standardet teknologjike në aksesimin e mikrodatave të INSTAT.

XII. DREJTORIA E STATISTIKAVE RAJONALE DHE GJEONFORMACIONIT

(1+13+49)

Drejtorja e Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit, sipas strukturës aktuale të propozuar, pëson rritje në numrin e punonjësve nga 16 në 63, si pasojë e kalimit të njërive shtesë në funksion të vijueshmërisë së procesit të punës. Kjo drejtori siguron realizimin e procesit të mbledhjes së të dhënave nga njësitë statistikore, menaxhon dhe monitoron procesin e vërtetimit në terren, administron arkivin e të dhënave të papërpunuara (pyetësorë) në format letër, koordinon veprimtarinë e zyrave rajonale statistikore në varësi të INSTAT, zhvillon procesin e mbledhjes së të dhënave në terren/burimeve administrative nëpërmjet zyrave rajonale të shpërndara në territor, si dhe kontribuon në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e gjeostatistikave, nëpërmjet përdorimit të hartografisë dhe Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS).

Brenda strukturës së drejtorisë do të funksionojnë disa sektorë, duke mundësuar kështu përmirësimin e procesit të planifikimit, realizimit, monitorimit, përpunimit dhe publikimit të informacionit statistikor të mbledhur dhe atij të referuar gjeografikisht, në mbështetje të planit të statistikave zyrtare.

Spektori i Planifikimit dhe Monitorimit të Mbledhjes së të Dhënave (1+5) është sektori që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi. Objektivat e këtij sektori janë të planifikojë dhe monitorojë mjetet e metodologjinë e mbledhjes së të dhënave në mbështetje të vërtetimit statistikore, duke ndërtuar sistemin e mbledhjes së të

dhënave në bazë të specifikave, përmbajtjes së informacionit dhe afatet e dhëna nga njësitë tematike që drejtojnë prodhimin statistikor. Siguron kontekstin e procesit të ndërtimit të ushtrimit të mbledhjes së të dhënave, menaxhimin e komponentëve organizativë dhe administrativë në mbështetje të mbledhjes së të dhënave. Monitoron zbatimin dhe ofron zgjidhje për menaxhimin operacional të problematikave.

Spektori i Koordinimit të Mbledhjes së të Dhënave (1+3) është sektori që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi. Objektivat e këtij sektori janë të koordinojë dhe administrojë procesin e mbledhjes së të dhënave në terren/burimeve administrative dhe kontaktet me Zyrtat Statistikore Rajonale. Ndërvepron me njësitë tematike që drejtojnë prodhimin statistikor mbi aspekte informative të përmbajtjes së vrojtimit, si dhe në menaxhimin operacional të zgjidhjes së problematikave. Sektori, siguron koordinim në procesin e publikimit të të dhënave dhe treguesve të statistikave rajonale.

Spektori i Gjeoinformacionit (GIS) (1+2) është sektori që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi. Objektivat e këtij sektori janë të krijojnë, mirëmbajë dhe zhvillojnë informacionin gjeohapësinor për qëllime statistikore, në mbështetje të prodhimit të statistikave. Me mjetet që ka në dispozicion, ky sektori planifikon, mbledh dhe publikon të dhëna statistikore të referuara gjeografikisht, sipas ligjeve në Republikën e Shqipërisë dhe standardeve/rekomandimeve evropiane, në funksion të prodhimit të statistikave asnjansë, transparente dhe të përditësuar.

Zyrtat Rajonale (10+39)

Struktura e re propozon kalimin e Zyrave Rajonale në varësi të Drejtorisë së Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit.

Zyrtat Rajonale të Statistikave do të funksionojnë me zyra në nivel qarku.

Numri i përgjithshëm i stafit të zyrave rajonale nuk ndryshon. Objektivat e këtyre zyrave janë zhvillimi i procesit të mbledhjes së të dhënave në terren/burimeve administrative dhe kontaktet e nivelit të parë (informacioni bazë mbi detyrimin për t'u përgjigjur, mënyrat e qasjes në sistemet e përdorura për mbledhjen e të dhënave, etj.) me të anketuarit (individët, familjet, bizneset, institucionet) veç monitorimit dhe kompletimit të procesit të mbledhjes së të dhënave. Ndërvepron

me njësitë e mbledhjes së të dhënave dhe ato tematike të prodhimit statistikor (thellimin në aspekte të përmbajtjes së informacionit të vrojtimit), si dhe menaxhimin e problematikave.

- **Zyra Statistikore Rajonale Tiranë** i shtrin funksionet dhe aktivitetin e saj në territorin që përfshin bashkitë që përbëjnë qarkun Tiranë. Numri i punonjësve të Zyrës Rajonale Statistikore është një përgjegjës dhe 3 specialistë (1+3). Shpërndarja në territor për specialistët është ajo që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi.

- **Zyra Statistikore Rajonale Elbasan** i shtrin funksionet dhe aktivitetin e saj në territorin që përfshin bashkitë që përbëjnë qarkun Elbasan. Numri i punonjësve të Zyrës Rajonale Statistikore është katër specialistë (0+4). Shpërndarja në territor për specialistët është ajo që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi.

- **Zyra Statistikore Rajonale Korçë** i shtrin funksionet dhe aktivitetin e saj në territorin që përfshin bashkitë që përbëjnë qarkun Korçë. Numri i punonjësve të Zyrës Rajonale Statistikore është një përgjegjës dhe pesë specialistë (1+5). Shpërndarja në territor për specialistët është ajo që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi.

- **Zyra Statistikore Rajonale Shkodër** i shtrin funksionet dhe aktivitetin e saj në territorin që përfshin bashkitë që përbëjnë qarkun Shkodër. Numri i punonjësve të Zyrës Rajonale Statistikore është një përgjegjës dhe katër specialistë (1+4). Shpërndarja në territor për specialistët është ajo që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi.

- **Zyra Statistikore Rajonale Lezhë** i shtrin funksionet dhe aktivitetin e saj në territorin që përfshin bashkitë që përbëjnë qarkun Lezhë. Numri i punonjësve të Zyrës Rajonale Statistikore është katër specialistë (0+4). Shpërndarja në territor për specialistët është ajo që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi.

- **Zyra Statistikore Rajonale Dibër** i shtrin funksionet dhe aktivitetin e saj në territorin që përfshin bashkitë që përbëjnë qarkun Dibër. Numri i punonjësve të Zyrës Rajonale Statistikore është një përgjegjës dhe dy specialistë (1+2). Shpërndarja në territor për specialistët është ajo që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi.

- **Zyra Statistikore Rajonale Durrës** i shtrin funksionet dhe aktivitetin e saj në territorin që përfshin bashkitë që përbëjnë qarkun Durrës. Numri i punonjësve të Zyrës Rajonale Statistikore është një përgjegjës dhe tre specialistë (1+3). Shpërndarja në territor për specialistët është ajo që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi.

- **Zyra Statistikore Rajonale Vlorë** i shtrin funksionet dhe aktivitetin e saj në territorin që përfshin bashkitë që përbëjnë qarkun Vlorë. Numri i punonjësve të Zyrës Rajonale Statistikore është një përgjegjës dhe katër specialistë (1+4). Shpërndarja në territor për specialistët është ajo që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi.
- **Zyra Statistikore Rajonale Fier** i shtrin funksionet dhe aktivitetin e saj në territorin që përfshin bashkitë që përbëjnë qarkun Fier. Numri i punonjësve të Zyrës Rajonale Statistikore është një përgjegjës dhe pesë specialistë (1+5). Shpërndarja në territor për specialistët është ajo që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi.
- **Zyra Statistikore Rajonale Kukës** i shtrin funksionet dhe aktivitetin e saj në territorin që përfshin bashkitë që përbëjnë qarkun Kukës. Numri i punonjësve të Zyrës Rajonale Statistikore është një përgjegjës dhe dy specialistë (1+2). Shpërndarja në territor për specialistët është ajo që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi.
- **Zyra Statistikore Rajonale Berat** i shtrin funksionet dhe aktivitetin e saj në territorin që përfshin bashkitë që përbëjnë qarkun Berat. Numri i punonjësve të Zyrës Rajonale Statistikore është një përgjegjës dhe dy specialistë (1+2). Shpërndarja në territor për specialistët është ajo që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi.
- **Zyra Statistikore Rajonale Gjirokastrë** i shtrin funksionet dhe aktivitetin e saj në territorin që përfshin bashkitë që përbëjnë qarkun Gjirokastrë. Numri i punonjësve të Zyrës Rajonale Statistikore është një përgjegjës dhe një specialist (1+1). Shpërndarja në territor për specialistët është ajo që funksionon edhe sipas strukturës ekzistuese, me të njëjtën përbërje, detyra dhe përgjegjësi.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE KOORDINIMIT

XIII. DREJTORIA E FINANCËS DHE PROJEKTEVE (1+4+10+10)

Sektorit të Prokurimeve (0+2) është përgjegjës për koordinimin, mbarëvajtjen, ndjekjen dhe realizimin e procedurave të prokurimit publik, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Ky sektor siguron të dhënat e nevojshme nëpërmjet Programit Ekonomik të miratuar dhe kërkesave të strukturave përkatëse në institucion dhe së bashku me anëtarët e tjerë të njësisë së prokurimit përgatit regjistrin e parashikimit dhe regjistrin e realizimit të procedurave të prokurimit publik. Sektori i Prokurimeve përgatit projekt-preventivin dhe specifikimet teknike, në rast prokurimi të një objekti tip të miratuar. Ai përzgjedh llojin e procedurës së prokurimit (dhe justifikimin argumentues kur është rasti), përllogarit fondin limit, në rastet kur kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme, harton urdhrin e prokurimit, përgatit dokumentet e tenderit dhe mbledh të gjitha materialet e nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, në rastet kur kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme. Ai gjithashtu harton dhe dërgon njoftimet për publikim, brenda afateve kohore të procedurave të prokurimit, në Agjencinë e Prokurimit Publik, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Administron të gjitha procesverbalet për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë dhe procesverbalet e mbledhjeve. Realizon në bashkëpunim me anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me blerjet me vlerë të vogël për mallra, punë dhe shërbime, me qëllim plotësimin e nevojave të institucionit. Me përfundimin e procedurave të tenderit, sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi dorëzon dosjen në arkivin e INSTAT. Shqyrton kërkesat dhe ankesat e ardhura në INSTAT, që kanë të bëjnë me prokurimet.

Në total, numri i kësaj drejtorie shkon nga 24 në 25 punonjës (10 nga të cilët me klasë page).

Sektori i Financës (1+4) mbulon të gjithë pjesën menaxheriale të institucionit sa i takon lëvizjeve financiare, likuiditeteve, raportimeve për planifikimet dhe realizimet e buxhetit.

Sektori i Burimeve Njerëzore (1+2). Funkzioni i këtij sektori është të mbështesë institucionin me staf permanent dhe të përkohshëm për mbulimin e aktiviteteve statistikore, të planifikojë dhe zbatojë politika zhvillimore për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit si dhe të ndikojë në rritjen e motivimit të tij, duke organizuar dhe monitoruar trajnimet që do të ofrohen në qendrën e trajnimit.

Sektori i Shërbimeve (1+10), ndjek procedurat ligjore për sa i përket planifikimit dhe administrimit të bazës materiale, evidenton dhe arkivon korrespondencën si dhe siguron kushtet e pastërtisë dhe sigurisë në ambientet e INSTAT-it. Gjithashtu, sektori merret me administrimin e shoferëve dhe automjeteve, magazinimin e bazës materiale.

Sektori i Koordinimit të Projekteve (1+2). Misioni është koordinimi, ndjekja dhe monitorimi i projekteve të institucionit me qëllim realizimin e tyre me sukses.

XIV. DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE ÇËSHTJEVE LIGJORE (1+2+4)

Misioni i kësaj drejtorie do të jetë sigurimi i përmbushjes së detyrimeve ligjore që lindin nga Ligji nr. 17/2018 në lidhje me Koordinimin e Sistemit Kombëtar Statistikor, përgatitjen e planeve zhvillimore afatgjatë, afatmesme dhe afatshkurtër në nivel kombëtar dhe institucional, si dhe të sigurojë mbështetjen ligjore për mbarëvajtjen e veprimtarisë së INSTAT.

Në përbërje të Drejtorisë së Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore do të jenë dy sektorët e mëposhtëm:

Sektori i Koordinimit dhe Planifikimit Strategjik (1+2) është sektor i cili ka si qëllim të merret me koordinimin e punës për përgatitjen e Programit të Statistikave Zyrtare, Planit Vjetor për zbatimin e tij, përgatitjen e raporteve periodike që i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm, Këshillit të Statistikave dhe Kuvendit. Sektori punon/kontribuon për krijimin dhe funksionimin efektiv të një rrjeti komunikimi midis institucioneve përgjegjëse të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe institucioneve private të cilët prodhojnë statistika ose disponojnë të dhëna për nevoja të përmirësimit të prodhimit statistikor. Sektori ndihmon në ndjekjen e punës për raportimin e zbatimit të PSZ, vlerëson ecurinë, identifikon dhe informon mbi problematikat që ndeshen gjatë monitorimit dhe propozon alternativa për zgjidhjen e tyre në kohë dhe me cilësi.

Sektori i Çështjeve Ligjore/Administrative (1+2), krijon dhe kontrollon ligjshmërinë e akteve administrative të institucionit, urdhrave, manualeve e rregulloreve të brendshme, harton projekt-aktet për përafrimin e akteve komunitare dhe krijon sisteme për monitorimin e përputhshmërisë së tyre. Sektori juridik mbështet veprimtarinë koordinuese të INSTAT për të siguruar kornizën ligjore mbi të cilën ushtron veprimtarinë Sistemi Kombëtar Statistikor. Sektori përpilon projekt-


marrëveshjet me institucionet që sigurojnë të dhëna administrative dhe institucione të tjera që ndikojnë në zhvillimin e statistikave zyrtare. Gjithashtu, sektori është përgjegjës për të ndihmuar në interpretimin e normave ligjore në fushën e statistikave, administratës publike, si dhe përfaqëson institucionin në çështjet e mundshme ligjore me të tretët, etj. Në përbërje të sektorit, përveç përgjegjësit janë edhe dy specialistë të profilit jurist.

XV. IMPAKTI FINANCIAR dhe të tjera


Efektet financiare janë të parashikuara në projektbuxhetin e INSTAT si dhe janë reflektuar në relacionin shoqërues të projektligjit “Për Statistikat Zyrtare”, i cili është miratuar në datë 05.04.2018.

DELINA IBRAHIMAJ

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



STRUKTURA E INSTITUTIT TË STATISTIKAVE



ORGANIKA E INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I DREJTOR I PERGJITHSHEM		1
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-b	1
SEKRETAR		1
II SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE I INTEGRIMIT EVROPIAN		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
III SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
IV DREJTORIA KOMUNIKIMIT DHE PUBLIKIMEVE		<u>(7)</u>
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN		<u>(2)</u>
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I PUBLIKIMEVE DHE MARKETINGUT		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
BIBLIOTEKAR		<u>(1)</u>
V DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRODHIMIT STATISTIKOR		
DREJTOR I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME	II-a	1
V/1 DREJTORIA E LLOGARIVE KOMBETARE		<u>(18)</u>

DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I LLOGARIVE KOMBËTARE VJETORE		(5)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	4
SEKTORI I LLOGARIVE TË SEKTORËVE INSTITUCIONAL		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	3
SEKTORI SINTEZË I LLOGARIVE KOMBËTARE		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	3
SEKTORI I LLOGARIVE KOMBËTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE		
QËNDRORE DHE RAJONALE		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	3
V/2 DREJTORIA E STATISTIKAVE EKONOMIKE		(18)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I STATISTIKAVE STRUKTURE		(5)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	4
SEKTORI I STATISTIKAVE AFATSHKURTRA		(6)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	5
SEKTORI I REGJISTRIT STATISTIKOR TË NDËRMARRJEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I STATISTIKAVE TË R&D, INOVACIONIT, TEKNOLOGJISË SË		
INFORMACIONIT DHE TRANSPORTIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
V/3 DREJTORIA E STATISTIKAVE SOCIALE		(18)

DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I STATISTIKAVE TË POPULLSISË		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	3
SEKTORI I ZHVILLIMIT TË STATISTIKAVE SOCIALE		(5)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	4
SEKTORI I STATISTIKAVE TË KONSUMIT TË FAMILJEVE		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	3
SEKTORI I NIVELIT TË JETESËS		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	3
V/4 DREJTORIA E STATISTIKAVE TË BUJQËSISË DHE MJEDISIT		(13)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I STATISTIKAVE TË TOKËS DHE PRODHIMIT BIMOR		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I STATISTIKAVE TË BLEGTORISË DHE PESHKIMIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I LLOGARIVE EKONOMIKE NË BUJQËSI DHE MJEDIS		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST PËR INDEKSIN E ÇMIMEVE	III-b	2
SEKTORI I STATISTIKAVE TË MJEDISIT DHE PYJEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
V/5 DREJTORIA E STATISTIKAVETE SEKTORIT REAL		(17)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I LLOGARIVE KOMBËTARE 3-MUJORE		(4)

PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	3
SEKTORI I TREGËTISË SË JASHTME		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I ÇMIMEVE		(5)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	4
SEKTORI I STATISTIKAVE TË TREGUT TË PUNËS		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	3
DREJTORIA E PERGJITHSHME E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE		
VI MBLEDHJES SE TE DHENAVE		
DREJTOR I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME	II-a	1
VI/1 DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT		<u>(28)</u>
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I MENAXHIMIT TË BAZAVE TË TË DHËNAVE DHE AKSESIT NË MIKRODATA		(7)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	6
SEKTORI I CILËSISË DHE METADATAVE		(5)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	4
SEKTORI I ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE KOMPJUTERIKE		(5)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	4
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË RRJETIT DHE SERVERAVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2

SEKTORI I METODOLOGJISË		(7)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	6
VI/2 DREJTORIA E STATISTIKAVE RAJONALE DHE GJEONFORMACIONIT		<u>(63)</u>
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I GJEONFORMACIONIT (GIS)		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I KOORDINIMIT DHE MBLEDHJES SË TË DHËNAVE		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	3
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE MONITORIMIT TË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE		(6)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	5
ZYRAT RAJONALE		(49)
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE TIRANË		4
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	3
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE ELBASAN		4
SPECIALIST	IV-b	4
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE KORÇË		6
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	5
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE SHKODËR		5
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1

SPECIALIST	IV-b	4
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE LEZHË		4
SPECIALIST	IV-b	4
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE DIBËR		3
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	2
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE DURRËS		4
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	3
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE VLORË		5
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	4
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE FIER		6
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	5
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE KUKËS		3
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	2
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE BERAT		3
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	2
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE GJIROKASTËR		2
PËRGJEGJËS	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	1

DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE MBESHTETESE DHE
VII KOORDINIMIT

DREJTOR I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME	II-a	1
VII/1 DREJTORIA E PERGJITHSHME E FINANCES DHE PROJEKTEVE		(25)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I FINANCËS		(5)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST BUXHETI	III-b	1
SPECIALIST FINANCE	III-b	2
SPECIALIST PËR FINANCIMET E HUAJA	III-b	1
SEKTORI I PROKURIMEVE		(2)
SPECIALIST	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	1
SEKTORI I PROJEKTEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I SHËRBIMEVE		(11)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
PROTOKOLLIST		1
TEKNIK/MAGAZINIER		1
NËPUNËS INFORMACIONI		1
SHOFER		3
PASTRUES/SANITAR		2
TEKNIK MIRËMBAJTJE		1
ARKIVIST		1
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	1

VII/2 DREJTORIA KOORDINIMIT DHE ÇËSHTJEVE LIGJORE

DREJTOR

II-b

(7)

1

SEKTORI I KOORDINIMIT DHE PLANIFIKIMIT STRATEGJIK (PSZ-së)

(3)

PËRGJEGJËS SEKTORI

III-a

1

SPECIALIST

III-b

1

SPECIALIST

IV-a

1

SEKTORI I ÇËSHTJEVE LIGJORE / ADMINISTRATIVE

(3)

PËRGJEGJËS SEKTORI

III-a

1

SPECIALIST

III-b

1

SPECIALIST

IV-a

1